



TARGET

Keep Antibiotics Working



Si të mblidhet një mostër urine duke përdorur peceta përthithëse ose qese për mbledhjen e urinës

Për foshnjat dhe fëmijët e vegjël

Qese për mbledhjen e urinës



1

Lani duart me ujë dhe sapun përpara dhe pas mbledhjes së mostrës.



2

Pastroni dhe thani zonën gjenitale të fëmijës.



3

Ngjiteni qesen mirë në lëkurën përreth organeve gjenitale dhe më pas vendosini fëmijës pelenën.



4

Pasi fëmija të ketë përfunduar urinimin, lani duart, hiqeni me kujdes qesen, prisni një cep të saj dhe derdhni urinën në enë sterile. Mos lejoni që qesja të prekë pjesën e brendshme të enës.



5


Vendoseni menjëherë kapakun mbi enë dhe mbylleni fort.

Pecetë përthithëse për mbledhjen e urinës



1

Lani duart përpara dhe pas mbledhjes së mostrës.




2

Vendoseni pecetën përthithëse brenda pelenës dhe vendosjani fëmijës si zakonisht. Kontrolloni pecetën përthithëse për mbledhjen e urinës çdo 10 minuta për të parë nëse është lagur. Mos e lini pecetën përthithëse për mbledhjen e urinës në pelenë për më shumë se 30 minuta, pasi kjo rrit rrezikun e kontaminimit të mostrës nga mikrobet.



3

Përsëriteni procesin duke përdorur një pecetë të re përthithëse çdo 30 minuta ose sa herë që fëmija kryen jashtëqitje, derisa të urinojë në të.



4

Lani duart përpara se të hiqni pecetën përthithëse. Përdorni shiringën e dhënë për të tërhequr urinën nga peceta përthithëse dhe për ta transferuar atë në enë sterile. Mos e prekni pjesën e brendshme të enës sterile me shiringë.



5

Vendoseni menjëherë kapakun mbi enë dhe mbylleni duke e shtërnguar mirë.



6

Mos përdorni pambuk, garzë ose ndonjë lloj tjetër pecete përthithëse, pasi ato mund të ndikojnë në rezultatet e analizës.

Udhëzime të përgjithshme

- **Pastroni dhe thani organet gjenitale të fëmijës** përpara mbledhjes së mostrës.
- **Lani gjithmonë duart** me ujë dhe sapun përpara dhe pas mbledhjes së mostrës së urinës.
- **Mos e hapni enën sterile** derisa të jeni gati për të mbledhur mostrën.
- **Përdorni peceta përthithëse ose qese për mbledhjen e urinës vetëm** nëse jua ka dhënë profesionisti i kujdesit shëndetësor

dhe ju ka shpjeguar mënyrën e përdorimit të tyre. Ndiqni çdo udhëzim që ju jep.

- **Shmangni prekjen e pjesës së brendshme të enës** dhe mos lejoni që organet gjenitale të fëmijës të vijnë në kontakt me asnjë pjesë të saj.
- **Nëse profesionisti i kujdesit shëndetësor jua ka kërkuar,** vendosni etiketën në enë përpara mbledhjes së mostrës.

Informacion përmbledhës

Pse duhet t'i ndjek me kujdes udhëzimet kur përdor pajisje për mbledhjen e mostrës së urinës?

Ndjekja e saktë e udhëzimeve ndihmon në parandalimin e kontaminimit të mostrës nga mikrobet, duke i bërë rezultatet e analizës më të besueshme.

A mund të përdor një kavanoz ose enë nga shtëpia?

Për mbledhjen e mostrës duhet të përdorni enën që ju ka dhënë profesionisti i kujdesit shëndetësor.

A ka rëndësi koha kur e mbledh mostrën?

Përpiquni ta mblidhni mostrën sa më afër kohës së vizitës suaj, në mënyrë që të sigurohet cilësia më e mirë e mundshme e mostrës.

Skani këtu
për më shumë
informacion



Këshilla për dorëzimin e mostrës së urinës

- ✓ **Dorëzoheni mostrën sa më shpejt**
Dërgojeni te ofruesi i kujdesit shëndetësor sa më parë të jetë e mundur, mundësisht brenda dy orëve.
- ✓ **Mbajeni në temperaturë të ulët**
Nëse nuk mund ta dorëzoni mostrën menjëherë, vendoseni në një qese plastike dhe ruajeni në frigorifer derisa të mund ta dorëzoni.
- ✓ **Kontrolloni orarin e pranimit të mostrave**
Pyetni se cila është ora e fundit për dorëzimin e mostrës, në mënyrë që ajo të arrijë në laborator po atë ditë.
- ✓ **Përdorni enë sterile të posaçme**
Disa enë përmbajnë një pluhur konservues dhe kanë një vijë orientuese që tregon nivelin e mbushjes. Përpiquni ta mbushni enën deri te vija e shënuar, por nëse kjo nuk është e mundur, mblidhni sa më shumë urinë që të mundeni.